



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Gjykimin e çështjes penale me Nr. 161 procedimi të vitit 2020, ndaj të pandehurve: **Ledia Ramo, Ortjon Dhami, Engjëll Dedja**, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë në tendera apo ankande publike*” parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal dhe **Bledar Shemaj**, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “*Falsifikim i vulave, stampave ose i formularëve*” parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal dhe “*Falsifikim i dokumentave*” parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal”.

2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvillua me rregullat e gjykimin të shkurtuar. Në përfundim të gjykimin, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët Rudina Palloj, Etleva Deda dhe Bib Ndreca, me vendimin Nr. **78**, datë **20.12.2024** vendosi:

- 1.** Deklarimin e pafajshme të të pandehurës **Ledia Ramo**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, ne referim të nenit 388, pika 1, shkronja b) të K.Pr.Penale, pasi fakti nuk përbën vepër penale.
- 2.** Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Ortjon Dhami**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, ne referim të nenit 388, pika 1, shkronja b) të K.Pr.Penale, pasi fakti nuk përbën vepër penale.
- 3.** Deklarimin e pafajshëm të të pandehurit **Engjëll Dedja**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike*”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 258 (para ndryshimeve me ligjin nr. 43/2021) në lidhje me nenin 25 të Kodit Penal, ne referim të nenit 388, pika 1, shkronja b) të K.Pr.Penale, pasi fakti nuk përbën vepër penale.
- 4.** Pushimin e akuzës ndaj të pandehurit **Bledar Shemaj**, për veprën penale “*Falsifikimi i vulave, stampave ose i formularëve*”, parashikuar nga neni 190 pg 1 i Kodit Penal, në zbatim të neneve 387 pg 1 dhe 328, pg 1, të K.Pr.Penale.
- 5.** Deklarimin fajtor të të pandehurit **Bledar Shemaj**, për kryerjen e veprës penale “*Falsifikimi i dokumenteve*”, parashikuar nga neni 186, pg 1 i Kodit Penal, dhe

- në bazë të këtij neni dënimin e tij *me 6 (gjashtë) muaj burgim*.
6. Në zbatim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, të pandehurit **Bledar Shemaj** i ulet 1/3 (një e treta) e dënimit të dhënë, duke u dënuar përfundimisht me *4 (katër) burgim*.
 7. Në zbatim të nenit 59 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë e të pandehurit **Bledar Shemaj** për një periudhë kohe prej *8 (tetë) muajsh*, me kusht që i pandehuri të mos kryejë vepër tjetër penale dhe gjatë kohës së provës të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës që mbulon vendbanimin e tij.
 8. Në bazë të nenit 190 të K.Pr.Penale, provat materiale të bashkuara me fashikullin mbeten pjesë e dosjes.
 9. Në bazë të nenit 391 të K.Pr.Penale, dokumenti “*Kontratë pune me datë 01.01.2019 me punëdhënësin Shoqëria “W.Center” sh.p.k dhe punëmarrës shtetasi Q.B*”, deklarohet i falsifikuar.
 10. Shpenzimet procedurale të bëra gjatë hetimeve paraprake, sipas procesverbalit për evidentimin e shpenzimeve të hetimit, dhe ato gjyqësore, sipas procesverbalit përkatës për evidentimin e shpenzimeve gjyqësore, në referim të neneve 393/1 dhe 285/1 të K.Pr.Penale, i ngarkohen të pandehurit të cilët deklaruar fajtor me këtë vendim.
 11. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar zbatimin e këtij vendimi.
 12. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brenda 15 (pesëdhjetë) ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Tiranë, më datë 20.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar